

VALTER MEMISHA

**VËZHGIME GJUHËSORE PËR VEPRËN
“SHËNIME NGA SHKOLLA E PARTISË”
E DAUT GUMENIT**

Kur më ra në dorë vepra “*Shënime nga Shkolla e Partisë*”¹ e autorit Daut Gumeni, tashmë një zë i identifikuar në letërsinë tonë përmes krijimtarisë në prozë e poezi², mbeta tërësisht i befasuar: i befasuar nga niveli artistik e arti i të shprehurit të botës shpirtërore të të persekutuaraëve, të internuarve a të burgosurve, që kanë zënë mend aq organikisht në rrjedhat e rrëfimit kujtesor të personazhit kryesor (që është vetë autori), i befasuar nga mesazhet e panumërta që si shumatore kanë përpjekjet dhe luftën për jetën e lirinë, duke mos u ndalur para asnjë vështirësie e pengese, por së shumti i befasuar, nga pasuria e madhe gjuhësore dhe veçanërisht nga koloriti popullor që gjëllin në çdo rresht e faqe të kësaj vepre.

D. Gumeni, që mishëron veten në vepër përmes personazhit Labo Gurra, përmes një sarkazme therëse e quan “Shkolla e Partisë”³ kalvarin e jetës së tij, që nga çasti që arrestohet gjatë tentativës për t’u larguar nga Shqipëria në vitet ’60 të shekullit të kaluar (*arratisje*, quhej atëherë), jetën e stërmundimet në kampet e punës, torturimet psikologjike e fizike në qelitë e birucat hetimit apo në ato të burgut politik. Daut Gumeni flet skajshmërisht vërtetësisht dhe bukur artistikisht. Vepra ka disa vjet që

¹ D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014.

² Daut Gumeni është, tashmë, një zë i identifikuar në letërsinë tonë bashkëkohore. Ai ka botuar këto vepra: “Legjendë lirie” (poezi), “Kënga e Zezakut të bardhë” (poezi), “Vallja e etjes” (poezi), “Udha e ëndrrës” (poezi), “Shënime nga Shkolla e Partisë” (roman), “Bletë dhe fishekë” (roman), “Mulliri i harruar” (tregime), “Sa larg është Danimarka” (ese), “Tranzicion apo trashëgimi” (publicistikë), “Ku jemi e ku vemi?” (publicistikë), “Puset me yje” (poezi), “Qershia e egër” (novela e tregime).

³ Titulli është sarkastik dhe autori nga reshti i parë e deri në fjalën e fundit të veprës ironizon e demaskon ideologjinë dhe politikën e regjimit komunist të viteve të socializmit në Shqipëri, dhe sidomos praktikën, mjetet e mënyrat e përdorura nga ky regjim, kur mëtohej se Shqipëria ishte kthyer në një shkollë ku edukohej njeriu i ri, njeriu i Partisë.

është në duart e lexuesit të zakonshëm, por edhe të studiuesve të letërsisë e të kritikës shkencore dhe ka marrë vlerësimet e merituar. Studiuesi Ylli Hoxhaj shkruan se autori në këtë vepër “na sjell të gjallë, ashtu të llahtarshëm, Ferrin që ngriti regjimi komunist i Enver Hoxhës ndaj të dënuarve politikë! Dhe ky Ferr, ndryshe nga Ferri dantesk, ndëshkimin e kishte si në Rrethin e Nëntë. Libri është dëshmi tronditëse e terrorit dhe e kimit shtetëror, por mbi të gjitha e qëndresës burrërore e heroike të atyre mijëra shqiptarëve që aspironin dhe therorizoheshin për lirinë. Autori, edhe pse është vetë në pjesën më aktive të këtyre bashkëvuajtësve, të qëndresës dhe të luftës së paepur të tyre në kampet e vdekjes, në roman ua lë shokëve vendin parësor.”⁴

Daut Gumeni e ngre në art këtë qëndresë ndaj një regjimi që nuk e llogariste jetën e kundërshtarëve politikë. Mjafton vetëm një pjesë tepër e shkurtër me një dialog midis hetuesit dhe të hetuarit, për të parë se e pavlerë ishte jeta e këtyre kundërshtarëve. Mendoj se aty thukësohet gjithë portreti i atij regjimi:

- *E gjen dot se gfarë po mendoja kur të vështroja në heshtje?*

- *Mbase dhe mendoje që “ky karabush që kam përballë kujton se do ta llogarisim si njeri, ndërkohë që për ne është vetëm një numër në regjistrin e madh të skllëvërve tanë... Një numër që, po të duam e shuajmë nga regjistri e po të duam e mbajmë”...*

- *Ma vodhe mendimin, kriminel! (f. 275-276)*

Apo:

- *Je dënuar, po ç’e do që nuk je përgjigjur akoma... Nuk na i ke thënë të gjitha dhe prandaj të kemi thirrur për herë të dytë... Që të na i thuash një për një të gjitha... Pse u arratisë?*

- *Për të shpëtuar nga ju – u përgjigj Laba, por hetuesi trupmadh e goditi befasi në rrëzë të qafës dhe e këputi në vend. Mezi e mblodhi veten nga inati, i nguli gjunjët në çimenton e dyshemesë dhe munda të ngrihej pa u rrëzuar sa gjatë gjerë.*

- *Të paskan mbajtur me mjaltë që të mos hapësh gojën... Qenke bërë tetëdhjetë e kusur qillo, po do të të bëjmë na 35 qillo e pastaj do të të shpiem tek gjashtëdhjetë qillot e pastaj prapë tek tredhjetë e pesë qillot, deri sa të thuash të gjitha ato që na duhen e pastaj një koqe plumbi bythëve dhe mbarojmë punë dhe më ty!... (f. 189)*

⁴ Y. Hoxhaj, cituar nga kapaku i pasmë i veprës, D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014.

Vëzhgime gjuhësore për veprën “Shënime nga Shkolla e Partisë”...

Në vijim po citoj përsëri studiuesin Ylli Hoxhaj, më shumë për të pohuar thukët disa tipare pikante të veprës “Shënime nga Shkolla e Partisë” e për të bërë pre të ngasjes lexuesit e këtij artikulli madje edhe lexuesit e një spektri shumë e shumë më të gjerë. Ai shkruan se “Në këtë vepër ka shumë dhimbje shumë krime, shumë vuajtje dhe vdekje. Këto autori na i jep të gjalla e rrëqethëse. Por është liria, shpirti dhe fuqia e tyre e kjo dëshmi shkëlqen në tërë veprën. Të mahnit forca e jetës dhe triumfi i saj! Kënga, humori i jashtëzakonshëm e solidariteti njerëzor, janë armët e pamposhtura të këtyre heronjve të lirisë. Një det me këngë e me humor nga tërë vendi, i bien kryq e tërthor gjithë veprës, duke u dhënë shpirtin e triumfit bëmave të atyre njerëzve edhe në fund të Ferrit. Kënga dhe e qeshura janë për ta armët e luftës dhe të fitores. Kënga e hap dhe e mbyll veprën si lajtmotiv i lirisë dhe i fuqisë së shpirtit njerëzor.”⁵

Në vepër sheh dhe një herë, tashmë me art, atë që ndodhte në jetën e zakonshme të njerëzve të kohës. Kushdo ndjehej tërësisht i pambrojtur nëse mendonte ndryshe, hapte gojën a ngrihej kundër pushtetit të diktaturës, i cili tregonte orë e çast dhëmbët. Provokimet, spiunimet, kërcënimet, dhe dënimet ishin kthyer në normalitet. Ja një shembull sesi përfaqësuesit e këtij pushteti, të kthyer në vegla pa shpirt, përçmonin e luanin me jetën e njerëzve, sidomos të atyre që u ishte privuar liria:

- Shikojeni, shikojeni – nisi operativi të fliste gjithë mllef. - E kam bërë me duart e mia! E nxora këtu përpara jush, që ta merrni vesh të gjithë. Ta marrin vesh edhe ata nga ju, që nuk u merr vesh koka dhe kujtojnë se mund t'i japin gjuhës si ky... Unë e marr atë fshatarin nga kooperativa, ashtu gjysmë të uritur, dhe i vë hekurat dhe e dënoj dhjetë vjet për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor, vetëm pse thotë që nuk ka gjizë në dyqanin e kooperativës!... Kujtoni ju se do lejoj unë që të ma hiqni gjuhën zvarrë dhe këtu në mes të telave me gjemba se, demek, nuk paskemi se çfarë t'u bëjmë më tepër?... Gaboheni rëndë! Gaboheni si ky këtu dhe do ta pësoni ca më keq se ky! Unë jam operativi i Sigurimit dhe për punët e Sigurimit të Shtetit nuk pyes as komandant e as komisar! Për punët e Sigurimit jam unë këtu dhe vendos vetëm unë! E doni më troç se kaq? Ja ku e kini shëmbullin dhe ankohuni ku të doni e sa të doni! Nga ky trajtim nuk shpëtoni, sa herë që të shani mbarë e mbrapsht udhëheqjen e lartë të Partisë, siç ka bërë ku ka mundur e si ka mundur ky maskara plak, që u paska mbajtur pishën të tjerëve dhe në Paris e në

⁵ Y. Hoxhaj, cituar nga kapaku i pasmë i veprës, D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014.

Bruksel!... Dhe nuk e mban dot gjuhën mes dhëmbëve të tij, po lëshon helm si nepërka sa herë që hap gojën... Merreni tani dhe ma rrasni në birucë, se e panë tani Sorbonasin e tyre se si katandiset, kur leh kundër udhëheqjes, si qentë kur i lehin Hënës... Besoj se me kaq u morëm vesh... Kur zhdëp kështu këtë, që po shkel të gjashtëdhjetat, është mirë t'i vënë gishtin kokës përpara se të hapin gojën ca të mençur në moshë të re, që u duket dhe miniera e kohës së Partisë si minierat e kohës së pirostive a të kusive, se nuk i hyjnë njeriu në punë kohët e baba Qemos... (f. 158-159)

Por veprën fund e krye, siç del nga fjalët e personazhit kryesor të librit, Labo Gurrës (vetë autori *Daut Gumeni*), e përshkruan ideja se liria është gjithçka, është mëngjesi e mbrëmja e njeriut, është dielli e hëna, është buka e uji, drita e ajri, zëri i fëmijës e drithërима e zemrës së nënës dhe në emër të saj mund e duhet të luftosh e të mos tërhiqesh, të qëndrosh e kundërqëndrosh, të synosh e të fitosh. Sipas tij *“Liria ka qenë e mbetet përherë frymëzim i bukur jo vetëm për mua... Liri për folur ato që mendon, liri për të shkruar ashtu siç mendon, liri për të qenë qytetar, që i paguan taksat dhe i respekton ligjet shtetit dhe jo vegël e verbër apo e trembur e pushtetit... Liri për të qenë i barabartë përpara ligjit dhe jo si ca bagëti të shënuara pas veshit nga biografia politike... Liri për të qenë njeri i lirë në një vend të lirë, ku nuk guxon kush të të thotë “këlysh qeni”, vetëm pse thua një të vërtetë...”*⁶

Vepra “Shënime nga Shkolla e Partisë”, thurur mbi një lëndë tërësisht reale, e cila ngrihet në art nga talenti krijues dhe mjeshtëria artistike e autorit, tipologjikisht qëndron midis një veprë kujtimesh (me një lëndë që vjen përmes shënimeve të mbajtura nga autori në vitet e “Shkollës së Partisë”) dhe një romani artistik (vetë autori e quan atë si të tillë, kur jep pasqyrën e lëndës duke shkruar se “Pesë tablo që mund të shihen edhe si një roman”: Kalaja (f. 11-62), Këneta (f. 63-118), Miniera e Pirustëve (f. 119-183), Qilari i kasapëve (f. 184-318), Balena prej betoni (f. 319 - 578”). Vepra, jo ditar libër kujtimesh, por “roman” artistik, sjell me mijëra copëza jete e ngjarje tërësisht të jetuara në mjedisin e kampeve të punës, në birucat e hetimit a në dhomat e burgut e aspak të trilluara. Autori D. Gumeni shprehet se në parathënien që e përcjell atë se *“Këtu do të mundohem të rrëfej për ju një pjesë të gjatë të asaj jete të thurur mbase më shumë me fillin e hekurt të telave me gjemba, sesa me atë fillin e lehtë artistik, që është gjithnjë i nevojshëm për ta bërë leximin tuaj më pak të lodhshëm e, mbase, edhe për t'i dhënë asaj jetës në Shkollën e Partisë edhe*

⁶ D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014, 266.

Vëzhgime gjuhësore për veprën “Shënime nga Shkolla e Partisë” ...

*një fije jetë më shumë. Të rendim pak tok nëpër terr pas bukureve (xixëllonjave - shënimi ynë, V. M.).*⁷

Edhe studiuesi Ylli Hoxhaj e përfshin veprën tipologjikisht si vepër të mirëfilltë letrare. Ai shprehet se “Satira e mprehtë dhe elegante, thellësia, pasuria e ideve, bukuria e parashtimit dhe e shtjellimit të tyre, qartësia e gjykimeve etike, politike e filozofike, origjinaliteti i rrëfimeve, gjuha brilante aq e begatë, mendoj se e bëjnë veprën të veçantë e një ndër më të arrirat e letërsisë së sotme shqipe.”⁸

Qëllimi i studimit tonë nuk rreh drejt ripohimit të vlerave letrar-artistike që kjo vepër mbart në rrafshin përmbajtjesor, apo drejt zbulimit të vlerave të reja dhe plotësimit të spektrit të tyre, por në përveçimin e vlerave të rrafshit të shprehjes së saj gjuhësore. Edhe në këtë rrafsh ajo mund të analizohet nga disa prerje. Pasuria që ajo mishëron, tërheq vëmendjen në të gjitha nënsistemet. Fjala shqipe në penën e autorit fiton peshë të veçantë, karakterizimet e jetës e të botës së personazheve dhe të mjedisit ku ata janë vendosur (ku jetojnë e veprojnë) janë nga tejet të arrira artistikisht e zënë vend denjësisht në letërsinë e vërtetë. Po japim vetëm disa rreshta të një peizazhi ku bukuria natyrore shihet përmes syve të një njeriu të dënuar me 25 vjet heqje lirie, sepse kërkonte vetë lirinë: “*Kur mbaroi apeli, zjarri i perëndimit po mekej e det e qiell bashkë nuk dukeshin më të përflakur, por të përgjakur. Telat me gjemba të rrethimit të jashtëm kullonin diellin e të vdekurve. Muzgu avullonte nga fusha dhe shtrihej tutje përmbi det për të pritur yjet. Të mos mbyteshin dhe yjet në det, si dielli.*”⁹

Pasuria e madhe gjuhësore që përdalohet në faqet e veprës “Shënime nga Shkolla e Partisë”, na bëri t’i hyjmë një sipërmarrjeje pak ndryshe: të përgatitim një lexim leksikografik të saj (duke hartuar një fjalor me leksikon e frazeologjinë që lidhet me botën e persekutimit dhe të dënimit politik). Ne kemi vjelë mbi 2.500 njësi leksikore (fjalë, njësi frazeologjike si dhe togfjalësha të qëndrueshëm e pjesërisht të qëndrueshëm me vlerë emërtuese) që do të përbëjnë lëndën kësaj vepre). Në Hyrjen e punimit mendojmë të ndalemi gjerësisht për këtë vlerë me peshë të saj. Kurse në këtë punim të shkurtër, duke u kushtëzuar nga kjo lëndë, e vjelë edhe për analiza e studime të mëtejshme leksikore e

⁷ D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014, f. 9-10.

⁸ Y. Hoxhaj, cituar nga kapaku i pasmë i veprës, D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014.

⁹ D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014, f. 65.

semantike, kemi përdorur shembuj që sendërtojnë jetën e njësive të vjela. Kjo ka sjellë një fragmentim të synuar të tekstit dhe veçoritë gjuhësore që kemi dashur të përdalohen, vijnë së shumti përmes segmentesh fjalish, sesa përmes pjesëve të vetëqëndrueshme përtej frazës. Në vijim po mjaftohemi me disa ravijzime nga fusha të ndryshme gjuhësore:

1. Shkrimtari D. Gumeni është jo vetëm një stilist i zot në narracion e në thurjet letraro-artistike (çka zbulohet lehtësisht kur lexon e recepton krijimtarinë e tij në poezi dhe në prozë), por ai njihet admirueshëm dhe *ligjërimet dialektore e krahinore të shqipës*, që në veprën “Shënime nga Shkolla e Partisë” dalin përmes portretizimeve të shumta gjuhësore vëmendjetërheqëse e mbamendëse të personazheve të internuar a të burgosur, apo përmes portretizimeve gjuhësore të jashtëzakonshme të punonjësve të administratës së institucioneve hetimore, gjyqësore, policore, të burgjeve apo të kampeve të internimit e të punës. Portretizimet vetjakësuese janë të papërsëritshme dhe shpërfaqin një nga vlerat më të mëdha gjuhësore të veprës, duke e bërë atë edhe të veçantë në llojin e vet. Duket sikur kemi një zbardhje / transkriptim të regjistrimeve diktofonike të situatave ligjërimore të shumta e absolutisht të tepërta dhe jo mbartje kujtesore e krijueshmëri artistike, të hedhura në faqet e një romani. Po japim në vazhdim shembuj / thënie që sjellim koloritet e të folmeve dialektore e krahinore, duke mos përveçuar gjuhën e njërit apo tjetrit personazh të veprës (që janë me qindra dhe që ligjërimi i tyre në vetvete formon një prerje tjetër interesante studimore, por kjo që mund të trajtohet / të realizohet nga studimeve letrare).

a. Thënie nga personazhe që i përkasin arealit gjuhësor të Labërisë: - *Hape mo këtë malule derë, që t’u mbilltë dera t’u mbilltë!* (f. 55) - *E, a djali i çeços, e. Ashtu i kemi kokë e shkëmënjë, po burri e do një çikë kockë që të mos hiqet xarraj e të bënet lolo, dreqi ta hajë!* (f. 130); - *Menien ua kam lanë atyne që lexojnë libra e shkruajnë edhe në këto kushte të vështira, apo ti vetëm lexon e nuk shkruen? – po dilte aty ku kish porosinë lokatori emërbardhë me zemër të zezë.* (f. 125); *Ndaj them se i mërzitur do jesh dhe ti brëna, në gufar.* (f. 130-131); *Se të dëgjoja njëdizaj kur bëje shaka me një qytyk anej nga anët tona dhe ia thoshje për merak të folurës vënçe, ashtu pleqërishte si ma do zëmra mua!* (f. 130) etj.¹⁰

¹⁰ Po japim një pjesë të plotë teksti, ku duken veçoritë e ligjërimin lab (asimilimi i grupit të bashkëtingëlloreve, shurdhimi i bashkëtingëlloreve në fund të fjalëve, përdorimi i zanores ë para bashkëtingëlloreve hundore etj.):

- *Pse i falënderon dëshmitarët, i pandehur? – e kishte pyetur kryetari.*

b. Thënie nga personazhe që i përkasin arealit gjuhësor gegë në Shqipëri: **Burgu për burrat asht, burra! E kot nuk thojnë burgu do bythë...** (f. 59); **Kët shoqin e kan dënue 25 kokrra vitesh e, siç po e shifni, nuk asht tu ni se e ka për herë të dytë e asht mësue me burg, i asht trashë e regjë lkura – qeshi përsëri baca Rremë.** (f. 61); **Se knej i thona gjuha llap e gjarpni dap!**” (f. 147); **-Nigjo, or ti tiranasi kryderr!** (f. 148); **Je lidhë e je zhdapë në dru, si ti e askush në kët brigadë.** (f. 147); **- Ajo nuk ishte e rrafme, po e coptueme! - e ngriti zërin lokatori i majtë.** (f. 160) **-Tanë mjekët e botës bajnë betimin e Hipokratit, ky durdridhuni e zemërthami këtu, ka ba betimin e hipokritit! – tha dom Shjefni.** (f. 410) etj.¹¹

c. Thënie nga personazhe që i përkasin arealit gjuhësor gegë në Kosovë: **Shuj mor ti e na len me ba një dorë muhabet me këto djeltë, që s’kanë pa allopran tuj u rrxu, shuj e mshoji venit aty!** (f. 328) **Mo, bre burrë se nuk du me të tanu, por du më të pa mbi maskarenjtë e Shqipnisë, me i shtypë atë farë të keqe!** (f. 383) etj.

d. Thënie nga personazhe që u përkasin arealeve gjuhësore bilingue: **Kujt i thua spiuni dhe kobure sa nje kemba mushka? - iu murrëtua më shumë Andartit fytyra e zeshkët me lëkurën e lyrshme, që ia bënte**

- Se nuk kam mundësi t’i çpërblej dot nryshe, zoti kryetar. Se më kanë shpëtuar nga kjo jeta, që ju i thoni “e lirë”...Më kanë bërë ner të math, se më dhanë munësi të më shpini prapë te shokët e miqtë e mi. Të jetoj si njeri e në mes të njërvësve dhe ato ditë që më kanë metur. Këtë jetën, që ju i thoni dhe “e lirë”, ta gëzoni vetë se mua nuk më duhet! Naj i falëneroj këta zotërinjtë dëshmitarë e ju falëneroj dhe juve si gjykatës, se më ka marrë malli për njerës e më ka marrë malli për shokët e mi të burgosur, më ka marrë malli dhe për muret e burgut, me ç’më kanë parë sytë në këtë jetën, që ju i thëni dhe “e lirë”. Majeni për vete e ta gëzoni sa të rroni! Mua më jepni dhjeçen e më dërgoni sa më shpejt te shokët!...” (Shih më gjerë D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014, f. 500).

¹¹ Po japim për ilustrim dhe një pjesë të vetëqëndrueshme teksti:

“Kur e pyetën shokët pse nuk e kishte shitur thesin me groshë, ai u përgjigj: - U i them burrë i fortë atij që shet groshët na pazarin e Shkodrës, burra!... Se m’u afru një horr Shkodret e më pveti: “Sa i ke groshët, malësia?” e u i thashë gjashtëdhjet lek kilen e ai më pordhi me gojë, burra! Hodha dorën në livore, po nuk e mora vesht qysh ma teti me grusht në mjekër, si me më ra më shkelm mushka e Marka Prengës! Nuk di me thanë a m’u rrotullue koka mue, apo u rrotullue toka... Taraboshi më dul në Maranj e Maranaji më dul në Trabosh e u rrexova dekun në tokë! ...Kur u permenda, ai horri kishte firu e kisha metun vetun në pazar!...Mora livoren e ngulun në tokë, hodha në krah thesin me grosh e një thes me marre dhe u ktheva pa shitë gja, si më patë!...” (Shih më gjerë D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014, f. 313).

këmishën e bardhë si nënbishte gomari. (f. 234); *Qe kur ka gene ne shkola te mesme, ai te pendehuri Labo Gura ngateronte dinjane, ngateronte, domethene!* (f. 304); *Ngateronte dhe kthente permbis nje shkola te tera, domethene!* (f. 304) etj.¹²

e. Thënie nga personazhe që përfaqësojnë persona të huaj që kanë mësuar a mësojnë shqip. Sjellim këtu për ilustrim letrën që i shkruan Labo Gurrës personazhi Maria, e burgosur polake, që del në skenë në çastet kur ai ishte në proces hetimor në Hetuesinë e Përgjithshme, Tiranë: *“Una jam polaka, emri kam Maria dhe nuk kuptoj pse do me vari ne mesi Tiranas, kur ty nuk kam bere asgje. Po ti, do te varin qe te marrin dhe nata dhe dita ne hetusia? Ate mbremja nuk haroj se pashe nje njeri kurajo buri dhe do mbaj mend gjithë koha. Maria nuk haron syri tendi te madhi me shikimi drita te bukura ne nata. Tani perqaoj fort me dashuria, Maria fatkeqi”...* (f. 244).

2. Në veprën “Shënime nga Shkolla e Partisë” e autorit Daut Gumeni, vjen bukur artistikisht *ligjërimi popullor*, që krijon një anë tjetër të spikatur të realizimit gjuhësor të saj. Kjo zbulohet në disa rrafshë (morfologjik, leksikor, sintaksor). Madje, autori e ul shumë dëndur dhe vetëdijshëm regjistrin e komunikimit, e kushtëzuar kjo jo vetëm nga zhanri i veprës, por edhe nga aftësia e tij për të shprehur me perceptimin e njerëzve të zakonshëm dhe përmes syve tyre jetën në “Shkollën e Partisë”: *Do të dëgjosh, rri e dëgjo, në mos po kric bythën e hiqmu nga sytë e mos na bën vapë! – nxehej Godoleshi dhe ordineri, që atë kishte dashur të arrinte me ngacmimin e tij, shkulej gazi sa e qeshura e tij bëhej ngjitëse.* (f. 92) - *Mos na e dhit muhabetin, ti palo ordiner malok!* (f. 92) *Do të dëgjosh, rri e dëgjo, në mos po kric bythën e hiqmu nga sytë e mos na bën vapë! – nxehej Godoleshi dhe ordineri, që atë kishte dashur të arrinte me*

¹² Po japim edhe këtu si ilustrim një pjesë të shkurtër por të vetëqëndrueshme teksti, ku duken veçoritë e ligjëritimit e një minoritari grek: *“ - Pse nuku besoje ti, mo kremneli, që nuku di as shqipi mira dhe dashke te behesh shkrintari! Une them jemi te gjitha palikari, domethene jemi trimi, si thoni ju ne shqipi dhe ti me thua palokari! Ajde mendja, ajde! Dukesh ti qe je frikacaku, se nuk di as fjala palikaris! Dhe pastaj na hiqesh si te mençuri shuma! Ha, mo kremnel, nuk me thua pse more rruga per arratsija? Kete pergjigje dua una! Di te ma thuash pse? Ha, mo kremnel, nuk di te ma thuash pse kerkove te arratisesh? Cila qe arsieja? Ja kete dua te me thuash! E thua, apo s’e thua, mo kremnel? Do ta thuash ti se, po nuku ma the me goja tendja, domethena, do t’ju zhvarrosim te gjithëve! Si familja e si fisi do t’ju zhvarrosim! More vesh, apo nuku more?...”* (Shih më gjerë D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014, f. 233).

Vëzhgime gjuhësore për veprën “Shënime nga Shkolla e Partisë” ...

ngacmimin e tij, shkulej gazi sa e qeshura e tij bëhej ngjitëse. (f. 92); - *Ku e lam muhabetin? Se ky ordineri do një dru të mirë, që të mësojë të respektojë më të moshuarit e më të mënçurit nga ajo koka e tij sa një gorricë!*- qeshte dhe vetë Godoleshi, tani që kishte marrë hak me ordinerin dhe shfaqja merrte përsëri udhë. (f. 92); *Ajo nuk qe gërhimë njeriu, po ulërimë derrash të lavosur!* (f. 107); - *U të rrënxofsha tët ëmë, të rrënxofsha!* (f. 111) etj.¹³

3. Janë të panumërta ndërtimet me ironi dhe sarkazma therëse: - *As që më shkon mendja të jemi të gjithë njëllor si veglat e punës!* (f. 113). *Tundi kokën me një kërcënim të përmbajtur vetëm që të mos “diskreditonte politikën e Partisë”, i dha përpara trupit të tij të krehur si të porositur për*

¹³ D. Gumeni me përshkruan me ngjyra, me dashuri e njerëzi të dënuarit e të burgosurit, por ai di të portretizojë bukur gjuhësisht dhe ata që këta të dënuar a të burgosur kishin përballë orë e çast. Ja me ç’gjuhë del në vepër një nga përfqësuesit e ligjit e të drejtësisë së shtetit të kohës (një mikrodialog me Labo Gurrën):

“- *Hiqmani nga sytë se dhe pak do që të nisë të lehë si ai tjetri! Thuaj shyqyr që shefi urdhëroi të të sjellim në katin e dytë e nuk do ta dëgjosh atë shokun tënd që leh si qen, deri sa të fillosh të lehësh vetë... Këtu jemi e do ta shohim dhe trimërinë tënde, hajvan me shkollë, që nuk di as të ruash bythën tënde! Na qenke nisur për t’u arratisur që të vazhdoje studimet jashtë shtetit, se këtu nuk të dham të drejtë të studioje aty ku doje e aq sa doje! Na u bë dhe bytha jote të zgjedhë ku të dojë, nuk e sheh? Edhe aq shkollë sa të lamë të merrje dhe jemi bërë pishman që të lejuam! Apo mos doje të të dërgonim dhe jashtë shtetit na, që pastaj të na lije strufat!...Mblydhe ate qyqe mendje që ke e eja në vete, përpara se të jetë shumë vonë, more vesh? Të flasin vetë shefat e mëdhenj të hetuesisë qendrore të Republikës dhe të flasin që të kthesh rrugë e të mbash qëndrimin e duhur për të mirën tënde dhe çfarë bën ti?... U kapardisesh dhe atyre si gjeli majë plehut! Të dhjefsha mençurinë, të dhjefsha! Ç’ke që më shikon ashtu si dhi e trembur? Nuk ia mbushkan syrin as shefat tanë më të mëdhenj zotrisë sate? E di ti se kush janë ata që po të flasin me urtësi, apo i kujton dhe këto nga ato “lojrat e Sigurimit” – siç u thua ti me atë mendjen tënde të bukur?...*

- *Ashtu si thoni ju, ata duken si komandanti dhe komisari i hetuesisë së përgjithshme - i tha Laba.*

- *Hiqmani këtë hajvan, se nuk na lë Partia t’ia tregojmë vendin ndryshe, pa ia kisha kënduar kulufurthin me një të goditur aty ku nuk ngrihej dot më me këmbët e tij!... Na tregon dhe komandantin e komisarin, pa le! Shpjereni të kalbet në birucë! Se na çau kokën na çau me gomarllëqet e tij pa taksë, pa doganë e pa kandar!” Shih më gjerë D. Gumeni, *Shënime nga Shkolla e Partisë*, Tiranë, 2014, f. 208.*

uniformën ushtarake dhe jo uniforma për të dhe vijoi më tej. (f. 138); *Ua ka zgjedhur partia e tyre, që bërtet se do ta çlirojë vendin e, në të vërtetë, do t'ia marrë fashizmit të zi e do t'ia dorëzojë fashizmit të kuq!* (f. 265); - *Po më thua që nuk më ke spërkatur me ujë, kur jam i tëri në det?...-ia ktheu Laba dhe për herë të parë e pa hetuesin e shogët të zbehej e t'i dukej vërtet koka si patate e zier dhe e qëruar.* (f. 281); **Të lumtë trapi**, o vëlla xhani, se kështu nuk jam trembur asnjëherë në jetë! (f. 81); **Të lumtë trapi, të lumtë**, o shoku oficer!- kishte qeshur i lehtësuar shoferi i shkretë. (f. 81); **Të lumtë vëra!** Mirë i tha ai bejtexhiu plak, kur e shtynë të kënonte me pahir atë këngën për Enverin: "Fol Enver të lumtë vëra,/ Se na i more të tëra!". (f. 131) etj.

4. Vepra "Shënime nga Shkolla e Partisë", si në asnjë vepër tjetër letrare e këtij lloji shpalos një pasuri të begatë *etnolinguistike*. Po ilustruamë disa fusha, pa komentuar apo pa ndalur në interpretime e klasifikime të mirëfillta e përimëtuese:

a. Kuptohet se natyra e lëndës që ka zënë vend në faqet e veprës do të shenjohej dukshëm nga *mallkimet* (që janë të shumta). Nuk ka segment të jetës që pasqyrohet në "Pesë tablo që mund të shihen edhe si një roman", ku ato të mos të gjenden: - **T'u mbajtët uji, t'u mbajtët!** (f. 56); *Nema mo gjënë time, të dhënçin në coqe, të dhënçin, ordiner i dënuar dizet herë!* – përpiquej t'ia merrte kartonin e tij partizan Meleqi. (f. 56); *Thanë sikur qe bërë gati të hynte dhe këtu vetullushi, po nuk di se pse nuk hyri t'i fshinte dhe këta koçobranët tanë, që i fshiftë e mos i lëntë!* (f. 132); *Paska kenë i pabesë e paska kenë kokrra e horrit, që e marroftë Zoti e marroftë!* (f. 175); *Gjynahet e tua me të burgosmit i pagjoi i vogli i nanës!* **Që dreqi ta marrtë shpirtin!** (f. 454); -*Ku je fut, o të hangshin shtatqind dreqën, me kët emën që më ke!* (f. 455); - *O Palush! O Palush, o të hangshin shtatqind dreqën, ku je?* (f. 456); *Ja shtu, o Palush, o të bafshin palë shtatqind dreqën, të bafshin!* (f. 455); **T'i hangërt dreqi veshët që më ke, pallosh groshi!** (f. 456); **Të baftë dreqi palmuç me gjithë veshë që ke!** (f. 456); - *Ça ke ba këtu ti, u bafsh lamsh me gjitha at "udhronin" tat?* (f. 456); - *E të marrtë dreqi ty e benzinën tane e zjarrin që më ke nezë, he zjarrri të përvloftë!* (f. 456); *Hup, të huptë fara të huptë!* - mezi mbante veten kapteri, duke e hedhur mbi tryezë faqoren e zbrazur. (f. 456); *Thuaje, moj t'u thaftë goja, t'u thaftë!* (f. 507); **T'u bëftë në grykë Nuri, t'u bëftë, se më ke nga një këngë për çdo gjë që ndodh dhe në birucat e grave!** - dëgjohej police Mineja duke shkuar drejt birucës, ku bëhej përleshja mes të dënuarave. (f. 218); *Paska kenë i pabesë e paska kenë kokrra e horrit, që e marroftë Zoti e marroftë!* (f. 175); *Se, ty dreqi ta*

marrtë frymën, malësorët nuk janë aq frikacakë! (f. 497); - *Po thuaje, moj kahpe' atë që presin njerëzit, thuaje moj ta thëntë hoxha në rrëzë të veshit!* (f. 507); - *Ta thëntë hoxha në rrëzë të veshit, pa çë do se ç'ke thënë ti!* - e nëmi Zotina 420 si gjyshe e inatosur. (f. 272) *Shuj, he të shitoftë zana, se na korite!* - iu turr malësori i vjetër hokatarit të pushuar nga llogaria për “shpërdorim detyre”. (f. 496) etj.

b. Nuk mungojnë në vepër dhe urime (edhe janë më të rralla se mallkimet): *Mirë që nuk ma shet sharkun se heq të zitë e ullirit nga supet e mia, në ato të djalit e pastaj si postiqe e shtruar e deri sa përfundon në qafë të kaut, po sikur na ke prerë dhe shakatë, të preftë e mira udhën, të preftë!* – kërkonte të ndizte gazin xha Reshati. (f. 479); *Hapëm rrugën, pa t'u bëftë pushka top, po e pate ti në dorë gjysmën e lekut!* - i bërtiti kapterit të shoqërimit pa e mbajtur dot zemërimin mësuesi i lidhur. (f. 45); *E paç gjithnjë Zotin me vete, mor djalë i mirë! Këtë të uron xha Spirua me gjithë zemër.* (f. 116-117) etj.

c. Gjejmë, gjithashtu, edhe betime (ku jo rrallë ndeshet dhe një dozë ironie): *“Për qiell e për dhe”, nuk e kap ma me dorë hostenin!* (f. 494); - *Asha (paça) Zotin, edhe një herë qi m'dhanë tetqin lekë, më bane me hjedhë tetqin firma!* (f. 103); *“Për shat shën Shlledër, për shpert të Kreshtit, për ner të Flamurit e për ideal të Partisë, jam tuj t'tërhek rrshanë për plan t'pjerrët e tuj t'vjerrë për shpatllash në njat shtyllë me t'hi aklli n'deje!”* (f. 137) etj.

d. Me interes për një studim gjuhësor janë dhe fjalët e urta, që janë përdorur me mjeshtëri: *“Kush ndan e qan, kurrë mos këndoftë!”* – thotë populli apo jo? (f. 217); *“Mendja e madhe, ha të zotin!”* - thoshte Shefik Kocka, kur e pyeste ndonjë i burgosur se pse ishte verbuar. (f. 418); *Mos i ndigjo horrat, se po u trazove me krunde, të hajnë pulat.* (f. 427); Përgjohej kudo Malo Gurra nga “bashkëpunëtorët vullnetarë”, se në klub “ç'ka barku i nxjerr bardhaku”, në miq mund të flitej për “komplote”, në shtëpi mund të “tallesh Partia e të shahej pushteti” dhe në stan mund “të pritëshin si miq diversantët” ... (f. 434); *Kam dëgjuar sikur ti nuk je dhe aq i kënaqur, apo do jenë vetëm llafe hallku dhe, kur i thonë, nuk dalin shamitë e dyqanit për të zënë gojën e xhihanit...* (f. 380); *“Mendja e madhe, ha të zotin!”* - thoshte Shefik Kocka, kur e pyeste ndonjë i burgosur se pse ishte verbuar. (f. 418); *Mos i ndigjo horrat, se po u trazove me krunde, të hajnë pulat.* (f. 427); Përgjohej kudo Malo Gurra nga “bashkëpunëtorët vullnetarë”, se në klub “ç'ka barku i nxjerr bardhaku”, në miq mund të flitej për “komplote”, në shtëpi mund të

“tallej Partia e të shahej pushteti” dhe në stan mund “të pritëshin si miq diversantët”... (f. 434) etj.

Gjatë përdorimit të fjalëve të urta me vlerë frazeologjike (të shndërruara figurativisht), mund të ndodhë prishja e strukturës së tyre (mund të përdoren të pjesshme ose të plotësohen me fjalë të tjera): (*Me ç’duken bathët, sivjet janë larg pashkët*) *Me ç’duken bathët, të gjithë ç’jemi këtu brenda, do kemi rast për t’i provuar dhimbjet me të tepërt.* (f. 60) etj.

5. Një prerje tjetër për studime gjuhësore në veprën “*Shënime nga Shkolla e Partisë*”, është ajo *psikolinguistike*. Çdo faqe librit krijon hapësira për vëzhgime e analiza të këtij lloji. Autori ka ditur të sendërtojë gjuhësisht me dhjetëra e dhjetëra situata e veprime psiko-emocionale të njerëzve / personazheve që gjëllin në roman. Po përveçoj një nga pjesët më të bukura (besoj se jo vetëm për mendimin tonë), ku personazhi kryesor, Labë Gurra përjeton dhimbshëm një ngjarje (e thjeshtë në pamje por me domethënie të fortë) që ndodhi ndërmjet nënës së tij dhe një nënoficeri të burgut të Burrelit. *Rimarrjet gjuhësore* janë nga më të goditurat e më të gjeturat, si elemente të ndërtimit të një teksti me ngarkesë psikologjike të jashtëzakonshme, duke lidhur mendimet e duke e bërë mjaft intensiv përjetimin e kujtimeve e e ngjizjen e përfytyrimeve:

“- *Nuk lejohet në burg kjo! Nuk ka vend burgu për kashtë dysheku! Merr vetëm këtë! – Ia hodhi sergjinë përmbi trastat e ushqimeve nënoficeri i rojes.*

Pirrën e mbledhur nga mëma buzë greminave me qefin më kokë, ia kishin derdhur policët përpara syve të mëmës. Aty përpara syve të rrëmbushur të mëmës e kishin marrë ushtarët duaj-duaj pirrën e dyshekut dhe e kishin flakur në vendin e mbeturinave të repartit(!). Si ta kuptonte mëma e urtë gjithë atë mëri që paskishin rojet e burgut me pirrën e mbledhur prej saj? Ç’faj u kishte pirra e mbledhur nga mëma me duar të zgjatura mbi greminë? Trembeshin rojet e burgut dhe nga bari i buzave? Apo trembeshin nga era e greminave?... Sergjia, që shtroi nën dyshek sapo u kthye në dhoma, binte erën e mirë të barit të thatë. Binte atë erën e greminës, që e lëmon pirrën që kur çel e deri sa rritet e hidhet valle buzë humnere. Vallja e pirrës me erën e greminës, i dilte përpara syve, kur prekte sergjinë, që kishte mbajtur barin e bukur të mbledhur me duart e mëmës. Vallën e pirrës me erën e humnerës e pa në sytë e rrëmbushur të mëmës, kur rojet e burgut i hodhën mbi trastat e ushqimeve sergjinë e zbrazur. Nga sergjia e zbrazur dilyn valët e pirrës që luanin me erën e humnerës... Valët e pirrës u derdhën kot nga rojet e burgut. Ato valë bari

të bukur përkundeshin në sytë e malluar të mëmës...Në sytë e malluar të mëmës e ngrinte dallgë pirrën e gjelbërt era e greminës... Ndizej vallja e jetës me vdekjen...” (f. 362).

Rimarrja gjuhësore kthehet në mjet të fuqishëm dhe për të shprehur qëndrimin ndaj egërsisë dhe antihumanizmit të regjimit. Po sjellim përsëri një pjesë me fjalët e Labo Gurrës.

- **Liri** për folur ato që mendon, **liri** për të shkruar ashtu siç mendon, **liri** për të qenë qytetar, që i paguan taksat dhe i respekton ligjet shtetit dhe jo vegël e verbër apo e trembur e pushtetit... **Liri** për të qenë i barabartë përpara ligjit dhe jo si ca bagëti të shënuara pas veshit nga biografia politike... **Liri** për të qenë njeri i lirë në një vend të lirë, ku nuk guxon kush të të thotë “këlysh qeni”, vetëm pse thua një të vërtetë... (f. 266)

6. Në vepër të tërheq vëmendjen edhe onomastika, sidomos emrat e përveçëm që kanë ardhur nga një apelitiv: *Kur kishte marrë fund lufta, **Gërmadha** kishte shpëtuar “për një qime” pa u kthyer në Shqipëri nga rusët.* (f. 106); *Do të dëgjosh, rri e dëgjo, në mos po kric bythën e hiqmu nga sytë e mos na bën vapë! – nxehej **Godoleshi** dhe ordineri, që atë kishte dashur të arrinte me ngacmimin e tij, shkulej gazi sa e qeshura e tij bëhej ngjithëse.* (f. 92); *Meqë të dy e kalonin të shumtën e kohës me libra, javën e dytë **Laba nisi ta bënte dhe ecjen e oborrit në bisedë me **Dhëmbëhalën**.*** (f. 336) ... *Por komandant **Domethëna** e shmangu me dorë dhe i doli përpara përfaqësuesit të ligjshmerisë socialiste.* (f. 485) **Gugusllavi** qeshte me shpirt kur i kujtohej se sa të gëzuar iknin për në shtëpi ata fëmijë të kequshqyer e ca më keq të mësuar nga operativi, kur **Gugusllavi** u mbushte duart me peshqit që kapte në lumë. (f. 492); **Komisar Tropullaku** dukej që nuk dinte gjë, se u afrua tek xhami i hapur i Gaz-it 69 dhe deshi të bënte dhe aty propagandën e tij të zakonshme (f. 183) etj.

Shpesh onomastika dhe toponomastika është tepër domethënëse:

- *Pse nuk thua më mirë **Spaçhauzen** (Kujto Mathauzen), O Kolëziu? - u fut i paftuar në bisedë llokatori i djathtë.* (f. 125)

7. Por në qoftë se ndalemi në vëzhgime e analiza në nënsistemet gjuhësore, *sintaksa* është fusha ku vepra kthehet në model të shkruari.

a. Zhdërvjelltësia e larushia e madhe sintaksore e ndërtimeve, me fjali të përbëra (por të pambingarkuara me pjesë), me fjali të thjeshta, mungesore a të paplota, kumtësisht të të gjitha llojeve, sjellin kondensim e intensitet informacionesh që të habisin për bukurinë e realizmit, me qartësinë e forcën e mesazheve. Po japim një pjesë:

- *Ore, çmenduraku i dreqit! Do ta mbash atë gojë ti, apo të të këput një që të gëlltitësh gjuhën! ...E ke dëgjuar atë thënien popullore*

ndonjëherë?... “Si të venë zogjtë, o korb? “– e pyetën dikur korbin dhe korbi u përgjigj: “Sa po venë e nxihen”...Edhe ti, në vënd që të vësh mend e të vish në vete, po shkallon përditë e më keq! Mblidhe ore veten! Se një herë vijmë në këtë të shkretë dynja... Shko aty në birucë, mbase i shkon dhe njëherë nëpër mendje dhe ato që të thanë në sy kushëriri e vëllai yt i madh... Mirë neve që nuk na beson që duam të të ndihmojmë të shpëtosh lëkurën... Mati dhe njëherë të gjitha, se kush e di? Mbase të kthehet dhe ty mendja për së mbari... Se, kur i thonë, “një herë vete e vjen kungulli”... more kungull i pabërë! Se njëzetë e ca vjeç je e nuk je tetëdhjetë e ca vjeç...Se, edhe në të lëntë gjykata gjallë, po mbajte këtë qyqe mendje, ne mund të të nxjerrim nga burgu, vetëm kur të bëhesh jo me një, po me dy bastunë! (f. 272-273)

b. Nuk mungojnë dhe pjesët e nënrenditura homogjene, që jo rrallë semantikisht lidhen me qëndrimet e veprimet çnjerëzore të aparatçikëve të drejtësisë së kohës: “Ala nuk të mbushet kaplloqja ty se **këtu jeni të burgosur dhe do hani kur duam ne, do pini kur duam ne, do punoni ku duam ne e sa duam ne, do pushoni kur duam ne e sa duam ne, do flini kur duam ne e do qeshni kur duam ne?.. Pse ke qeshur dje me fjalën time, po të them?- po merrte zjarr komisari.**” (f. 76)

c. Gjymtyrët homogjene e frazat homogjene janë një tjetër veçori stilistike e veprës, sidomos ato që portretizojnë, fillojnë e plotësojnë: *Boletini – siç e thërrisnin të gjithë ata që e njihnin - kishte humor artisti, mendje diplomati, guxim luftëtari, zemër fëmije, shtat të burgosuri dhe krenari atdhetari.* (f. 127)

8. Në ecurinë e punë sonë për nxjerrjen në pah të pasurisë gjuhësore që gjallon në faqet e kësaj vepre (duke parë në nivelin e kësaj kumtese vetëm vëzhgime leksikore e frazeologjike), nuk jemi ndalur në rrafshin e përmbajtjes.

Së pari, në jemi ndalur në disa dukuri që lidhen me pasurinë fjalësore të veprës “Shënime nga Shkolla e Partisë”, të autorit Daut Gumeni.

a. Kushtëzuar nga natyra e përmbajtjes së veprës vetiu që lexuesi i saj, së pari, kontakton *me një leksik specifik* (i quajtur ndryshe dhe *leksik dëftues*), që, siç jemi shprehur disa herë më parë, na lidh, me një anë specifike të jetës në kohën e monizmit në Shqipëri: me persekutimin, burgosjen apo me dënimet kapitale për shkak të bindjeve politike: *armik, armik i popullit, armik i pushtetit, armik i partisë, arratisem, arratisje, i arratisur, hetoj, hetues, kryehetues, hetim, i hetuar, hetuesi, hetuesi e parë, hetuesi e dytë, hetuesi e tretë, dënim i parë, dënim i dytë, burg, burgos, burgosje, i burgosur, i burgosur ordiner, i burgosur politik, gjyq, gjyq*

popullor, gjyq shembullor, dënoj, dënim, i dënuar, izoloj, izolim, i izoluar, pushkatoj, pushkatim, i pushkatuar, i persekutoj, persekutim, i persekutuar, persekutues, hafije, kapter, polic, birucë, birucë e nëndheshme, hekura (pranga), spiun, spiunoj, i spiunuar, mosspiunim, denocoj, denoncim, denoncues mosdenoncim, lidh, i lidhur, dëshmitar, birucë hetimi, dhomë (birucë) e izolimit, Seksionit të Brendshëm, Ministria e Punëve të Brendshme, prokuror, prokurori i përgjithshëm, kryeprokuror, kamp pune, ajrim, dënim i tretë, dëshmi e rreme, komisar i repartit, komandanti i repartit, shefi i policisë, operativ, operativi i zonës, rregullore e kampit, rregullore e burgut, grup antiparti, agjitacion e propagandë etj., etj.

Po japim disa shembuj ilustrues: **Komisari dhe operativi me të vetët, hapën fjalë se nënoficeri i furnizimit të burgut ishte dorëlëshuar jo vetëm me ushtarët, por dhe me të burgosurit.** (f. 546); - **Pa lere atë punë, o shoku prokuror, se pardje më sollën dhe katër arka të tjera me pendrekë nga Goma e Durrësit e nuk m'i kanë sjellë të luaj cingla me ta, po m'i kanë sjellë t'i shqep në dru këta armiq, sa herë që nuk më rrinë mirë e më shkelin rregulloren e dhomave të izolimit në këtë burg!** (f. 485); **Madje njëri nga krerët që e kishte afruar shumë të dërguarin e Seksionit të Brendshëm dhe e kishte nisur disa herë me grupet e asgjësuar, nuk donte ta besonte djalin, që e njihje policin e komandës së vendit.** (f. 418) etj. Fjala **hetuesi 349**, fjala **burg 1351**.

b. Në vepër të tërheqin vëmendjen dhe shumë fjalë të njohura nga shqipfolësi, por që në vepër fitojnë ngjyrimet e vlera të reja shënuese shprehëse, sidomos kur ato vështrohen në sintagmatikën e tyre fjalësore. Ato kanë peshën e tyre, jo vetëm për të ndërtuar mendimet, por edhe për të përdalluar mjedisin e persekutimit, të dënimit a të torturimit fizik e mendor ku shfaqen personazhet e veprës-roman: **Nuk kam sesi t'ju falënderoj! – iu drodh zëri të burgosurit plak dhe ktheu kryet mënjanë të fshinte një lot që i ra në rrudhat e faqes.** (109); - **Nuk thua shyqyr që nuk u bërë shah i Iranit, se ku do të kishim njohur? – ia mbyllte rrëfimin ordineri matjan Godoleshit gjysma partizan e gjysma ballist dhe shfaqja mbyllet me opingën e Godoleshit, që fluturonte për të gjetur kokën e mikut të tij thumbues.** (f. 93); **E dëgjonte në heshtjen e kaponit të përgjumur atë thirrjen e tij: “Mos u besoni këtyre bakabonëve! Mos u thyni!”** (f. 97)¹⁴

¹⁴ Po japim një pjesë nga libri, ku përsëri duket se sa mjeshtërisht autori portretizon me bukur me fjalë të njohura apo me njësi leksikore me përdorim të gjerë: “- E dëgjove apo jo? - tha “Zotnia 420” sapo doli shefi i mërztur. - Është

c. Një vend të rëndësishëm zënë në vepër qindra fjalë, që nuk janë në fjalorët shpjegues të shqipes dhe në to bëjnë pjesë fjalë të krijuar nga autori (një proces e ndihmesë që duhet çmuar, sepse janë formime të bukurfarkuara), por dhe dhjetëra fjalë që gjëllin në gojën e popullit dhe riaktivizohen me mjeshtëri nga autori, duke treguar dhe një herë se leksiku normativ i shqipes duhet të jetë më i hapur ndaj njësive të ndryshme që i gjen në të folmet dialektore e krahinore. Po japim për ilustrim:

- *Që ke lakra në kokë, këtë e kemi marrë vesh me kohë - ndërhyri në ndihmë të kolegut të vet hetuesi me një kokë të shogët e të **xhungët** si patate.* (f. 253); - *Sa për dijeni, ne kemi tru në kokat tona dhe bën mirë të mos i japësh gjuhës aq shumë! - po e humbte durimin e shtirë dhe hetuesi i ri **kokëshogët** dhe fytyra e tij e kënaqur nuk ngjante më me lepurin e butë.* (f. 254); *Ti vërtet që ia veshe turinjve me sahanin e supës asaj **bythëzvarrisurës**, po unë e bëra kapter Bilen t'ia mbathte nga sporteli!* (f. 261); *Cinxoja i mutit, që **çërrit** tërë kohën si **gishtoja** në vesh të kaut!* (f. 270); - *Krijuesi i asaj teorisë suaj jetëdhënëse, apo **jetëmarrëse**, parashikoi që revolucionin proletar do të fitonte në fillim në vendet më të zhvilluara të botës.* (f. 268); *Shefi u shqetësua dhe dërgoi **dhëmbëveshurin** të shihte nga afër gjendjen e të kërkonte zgjidhjen më të shpejtë.* (f. 285); *Sa u ul treshja gjykuese, e përbërë nga kryetari i gjykatës së Rrethit dhe dy ndihmësgjyqtarë popullorë, nga ata aktivistët dyjavorësh, që dukeshin më shumë si **ndihmësqqarë** se si ndihmësgjyqtarë, në sallë ra një heshtje e frikshme.* (f. 290); - *Babai im është një bari injorant, zoti kryetar – tha kushëriri shkoqur fare dhe mërmërima **mospranuese** e sallës këtë herë*

shefi ynë i madh ai, o gomar e nuk flitet me të ashtu katra-putra siç flet ti! Ta tha troç ai, po kujt ia tha, se! Kur shkruaje ashtu me talent, si thonë dhe këta shokët tanë, pse nuk shkruaje për Enver Hoxhën, o gomar, po shkruaje si armik populli! Ç'të duhej shprehja e armiqësisë dhe me shkrim, që të dhjefsha mëncurinë, të dhjefsha! Se më duket ta thashë dhe dje... Ç'të duhet një mëncuri që të sjell në këtë derë? Për të të zënë kokën me derë, të duhet ajo mëncuri e pjerdhur?... Nuk e sheh as tani që paske qenë një gomar i madh e që nuk ka shkollë të ta heqë gomarllëkun nga ajo kokë?... Rri sipër tani bajgës që ke bërë dhe mos u mundo të bësh dhe trimin me ne, se do të të bëjmë çeço na këtu! E di ti kujt i thonë çeço, apo nuk e di?... Shko tani e mendohu mirë aty në birucë, mendoji mirë ato pyetje që të bëri shefi i madh e mendoji mirë dhe këto që po të them unë. Mendoji thellë dhe, kur të të thërrasim prapë, të kesh ardhur në vete, more vesh?... Hiqeni hajvanin e shpjereni të mendohet! – u tha vartësve të tij “Zotnia 420” dhe u mbush me frymë, duke e nxjerrë më përpara barkun e tij kaba.” Shih më gjerë D. Gumeni, Shënime nga Shkolla e Partisë, Tiranë, 2014, f. 202-203.

ishte më e fortë. (f. 293); - Dëshmitari Shefik Kocka! - thirri kryetari i gjyqit dhe prunë për krahu një plak **të rrazbitur**, që nuk shihte mirë nga sytë dhe fliste një shqipe gjysma-gjysma. (f. 296); Cili është mendimi juaj për letërsinë dhe si e shikoni ju rolin e rinisë në shoqëri? – pyeti si me drojë ndihmësgjyqtarja tjetër – një grua e re me pamje **të paqtë** dhe me një zë **të kadifejtë**. (f. 309); E habiti butësia e zërit dhe tiparet e përvuajtura të atij polici të vjetër, që dukej sikur ishte nga një racë tjetër me atë të kuqos **dhëmbëngrënë**. (f. 320) Kurse atë nenin për **mosdenoncim** apo thënë shqip “për **mosspiunim**”, unë mbusha 30 vjeç dhe nuk më ka thënë njeri deri më sot pse nuk spiunon vëllain apo cilindo qoftë! (f. 311); - Hape pak këtë, hape! – urdhëroi pas derës një zë dhe, kur u hap dera, në prag të birucës u duk një ushtarak shkurtabiq e i **rrumbullosur**, që fliste me një ton **të përhedhur**, sikur përkëdhelte veten. (f. 322); Meqë të dy e kalonin të shumtën e kohës me libra, javën e dytë Laba nisi ta bënte dhe ecejen e oborrit në bisedë me **Dhëmbëhalën**. (f. 336); Ishte koha kur fushata e **ridënimeve** dhe e dënimeve në burg, përpiquej të qetësonte disi frikën e diktatorit nga zgjerimi i goditjes politike. (f. 337); Merrte nëpër vitet e luftës si strehë për mushkat e divizionit malor të pushtuesve italianë dhe dilte në vitin 1946, për të mbajtur në barkun e vet rreth 600 burra të burgosur, shtrirë dhomave dhe korridoreve të saj të ftohta, ndriçuar me pishtarë **tymlidhur**!... (f. 324); - I sheh këta, që u hanë duart të **të peleqisin** me ata bishta kazme? - e pyeti të dënuarin e birucës zëri i vrazhdë. (f. 324); I duheshin Sigurimit ata të burgosur **shpinëthyer**, për të thyer shpinën e të burgosurve që mbaheshin ende më këmbë. (f. 350); “Të dërgova të shkolloheshe deri në Frengji’, nuk e kurseva floririn që të më ktheheshe më i zoti në shokë e të na shtojte togun e të na rritte emrin e jo që dhe ti, biri im i zgjedhuri, të merrje mendjen e atyre **koçobranëve**, që kërkojnë të na futin të gjithëve në një vathë si dhëntë tona! – ziente babai i tëri. (f. 358); Më vjen dhe keq, kur kujtoj se si më hëngrën pas shpine këta **gaxhivarët**! (f. 358); Nuk ishte njeri i **grindur** ai! (f. 358); Të dëgjonte mëmën **të logatë** si ajo e asnjë tjetër! (f. 362); Të dëgjonte **logorimën e paqtë** të mëmës e të rritej me atë logorimë, që dukej sikur dilte nga dhimbja e dheut! (f. 362); Nuk vonoi dhe **Gërhütësi** – siç i thoshnin në dhomë një të burgosuri që gërhiste si traktor – u ngrit nga gjumi i trembur: (f. 364); Se njerëzit nuk hanë bar, siç kujton propaganda juaj **vetëlëvduese**. (f. 402); Dhe të afrohej me një ledhatim **përgjumës**, një ledhatim që të largonte dhe hijen më të lehtë të dhimbjes fizike. (f. 408); Dhe nuk qenë njerëz dosido, po ishte në krye të tyre Mihal Bellkameni – vëllai i Spiro Bellkamenit **emërndritur** e punëbukur! (f. 411); Dhe nuk

qenë njerëz dosido, po ishte në krye të tyre Mihal Bellkameni - vëllai i Spiro Bellkamenit emërndritur e **punëbukur!** (f. 411); - A **kokëdhogë** a kokëdhogë! - iu drejtua shokut të Labos - Kur të thoshja unë, nuk të mbushej ajo kokë, që ma ke dhogë, ma ke! (f. 413) etj.

d. Krahas fjalëve të reja në veprën dalin me dhjetëra kuptime të reja, që plotësojnë strukturat kuptimore të fjalëve të njohura gjegjëse. Po japim disa shembuj me fjali: *Dhe erdhën pastaj këta shejtanët **kuqalashë**, de!* (f. 334); *Ajo godinë **dykrahëshe** dukej sikur ishte ngritur mbi një tunel të padukshëm, që e lidhte me **rropullitë** e dheut.* (f. 184) **Ah!-u** i birucave (f. 184); *Ndërsa shefi me trup **zgërbonje** po fliste, gusha e tij e bëshme i varej më shumë dhe Labos iu kujtua “Zotnia 420” në filmin e aktorit të njohur indian.* (f. 195); - *Po që do të ta ndryshojmë jo vetëm vështrimin tënd të shtrembër, por edhe të gjithë qëndrimin tënd **kokëgdhe**, të ka vajtur në mendje?* (f. 211); - *Mbylle **halenë**, moj buçe se do të mbyty fare!* – i bërtiste gardiania duke i rënë më keq të burgosurës së pabindur. (f. 219); *Unë nuk kam qenë kurrë **i organizuar**, që të akuzohem për revizionist...prokurori duhet të ruhet për vete, se mund ta akuzojnë shokët e partisë së tij si revizionist.* (f. 302); *Kaq e ka **takatin mendor**.* (f. 224); *Sapo mbaroi izolimin dhe shkoi në dhomë me të tjerët, i pari shok që pyeti për policin e vjetër me zë të dhembshur e tipare të **kripura**, ia dha një të qeshure çlodhëse.* (f. 321); *Dashke të më bësh dhe shok e të dal **karkacul** këtu në si të këtiire burrave!* (f. 504) etj.

e. Në vepër gjenden dhe shumë një që nënkuptojnë një leksikalizim në proces, dukuri që lidhet drejtpërdrejt me formimet mbiemërore nga pjesoret e foljeve (prej të cilave nuk i kanë shkëputur akoma valencat sintaksore). Po ilustruam: *Avulluar (i, e) mb. Ta shikoje kumarxhiun sesi i binte ballit duke kujtuar “shkarkimin nga posti i sekretarit të partisë të kooperativës”, sesi përqafohej me Xhoxhin për ta “ndarë bashkë atë ditë zie”, do qeshje se s'bën, sado keq të të vinte për plakun e **tallur** jo vetëm nga kumarxhiu por dhe nga mendja e vet e **avulluar** nga zjarri partiak.* (f. 165); *Lajmet që vinin në burg dëshmonin atë lidhjen e lashtë midis pallatit dhe bodrumit, aq saktë të **mishëruar** në atë burgun e famshëm kinez me formë kërmilli, që sundimtari i kohës e kishte ndërtuar për të dëgjuar me veshët e vet nga kamarja e vogël e portës se çfarë thoshnin kundërshtarët e tij në qelitë e burgut.* (f. 423); *Një dëshmitar i kompleteve të **stisura** nga frika e diktatorit dhe nga zelli i shërbëtorëve të tij për t'iu afruar sa më shumë pushtetit.* (f. 423); *mb. Labo Gurra flinte vonë, sepse natën ishte koha më e përshtatshme për të lexuar e për të shkruar **i patrazuar** nga ordinerët e Brigadës së Kuqe.* (f. 423) etj.

f. Një vlerë tjetër gjuhësore leksikore dhe një nga tiparet për t’u përveçuar e librit “Shënime nga Shkolla e Partisë” është dhe pastërtia e leksikut. Në rreth 600 faqe narracion rrallë, shumë rrallë ndeshim ndonjë fjalë të huaj, dhe ajo e përdorur me vlera të theksuara stilistike: *Poezi shkruan dhe shumë shokë e shoqe të tjera si mbesopulla ime, po jo **thagma** armiqësore si ato të tuat!* (f. 202); - *E shohim të gjithë se ç’mall është, mo shok, po kemi dhe punë të tjera na e nuk do rrimë ta tororisim aq gjatë këtë **biçim** poeti të shkalluar.* (f. 235); ***Andarti** nuk priti sa të vinte kapter Aljoshë për ta marrë të pandehurin, por e shoqëroi vetë.* (f. 236); *Po binte nata dhe dritat e rrethimit i hidhnin burgut një ndriçim të kobshëm, që e bënte dhe urën prej betoni midis dy godinave-hejbe të dukej si ura e **xhehenemit**.* (f. 236); *Se po na marrin frymën e pa na mytin **bigarihak!*** (f. 383); *Dhe e pa mirë, që e pafshi **për mysybet** e **për garramet** ju të rinjtë! Ju, që do mbeteni për ta parë, se unë i kam bërë ditët e mia me kohë...* (f. 416-417); *Nga ekipi burrelas, Babagjyshi do të bënte kuzhinierin dhe **veqilharxhin** e anijes së vogël, duke u kujdesur për blerjet e ushqimeve, sa herë që të dilnin në limanet e brigjeve të detit.* (f. 460); *Paske qenë më **dahat** nga ai gënjeshtari i Konispolit!...* (f. 502) etj.

Së dyti, te pasuria në nënsistemin leksiko-semantik në librin “Shënime nga Shkolla e Partisë”, bie në sy numri i jashtëzakonshëm i *njësive frazeologjike* (ne kemi vjelë rreth 1700 njësi të tilla, një pasuri në kuptime vërtetë të fjalës, për t’u admiruar). Rrallë mund të gesh një pasuri të tillë në një vepër letrare, e çfarëdo zhanri qoftë. Ky numër shtohet ndjeshëm, nëse marrim parasysh se një pjesë e madhe e njësive frazeologjike del disa herë e përsëritur. *Frazeologjia* bëhet sendërtuese parësore e mendësisë dhe e ngjyrimit shprehës popullor. Kështu Daut Gumeni shfaq dhe një tjetër vlerë të shtuar gjuhësore, lidhjet e drejtpërdrejta, të shumëfishta dhe të ndërliqura me kulturën, mendësinë e mençurinë popullore. Kjo pasuri mund të bëhet objekt studimi i veçantë, sidomos për motivimin e brendshëm të njësive frazeologjike, ku mund të zbulohet një nga fushat ku krijueshmëria (kreativiteti) popullor i shqipes është nga më të spikaturit në qerthullin e gjithë gjuhëve që gjallojnë sot. Etnografia e të folurit gjen lëndë të begatë për studimet e veta.

Nisur nga përdorimi i tyre me mjeshtëri, ne kemi bërë vjelje gati shteruese të këtij grupi paradigmatic njësish. Nuk ka faqe që mos të hasësh njësi frazeologjike. Madje gjen shumë dendur fjali me disa njësi të tilla brenda vetes. Po japim vetëm një pjesë të shkëputur nga, ku gjenden mbi 14 njësi frazeologjike:

“- **Mbylle buçen!** Dashkemi të tregohemi dhe zemërgjerë me armikun e popullit, pa le! - **Mori përsëri zjarr** shefi i ekipit kryeqytetas. - Ju thashë dhe më parë, shokë – u kthye nga kuadrot që mbushnin zyrën e nënkryetarit të parë të Degës - neve **kemi ujkun e nuk kemi pse lodhemi për të gjetur gjurmët.** Na mjaftojnë ato palo vjershat e tij, **shkruar e zeza mbi të bardhë,** me një armiqësi të neveritshme!... Na mjafton që e kapëm në kufi **si miun në çark!**... Neve përpiqemi **t’i japim dorën** dhe një herë, po kur nuk do vetë, ç’ t’i bëjmë neve? **Le të ikë me të shumët** dhe ky, se **nuk na priset gjiza** për një më shumë e një më pak nga tarikati i tyre!... **Hiqmani këtej se më vret sytë!** Nuk keni pse e zgjatim më shumë hetimin e tij. **Bëjeni gati** për në gjyq dhe, po e **la gjykata gjallë,** përcillenit atje **ku e ka vendin. Hiqmani sysh!**...” (f. 42-43)

Frazeologjia në librin “Shënime nga Shkolla e Partisë” mbulohet nga një spektër shumë i gjerë burimor. Ajo së pari vjen si frazeologjia e krijuar nga goja e popullit, së shumti nga mençuria labe, por nuk mungojnë dhe njësi që vijnë nga sfera e kulturës dhe e dijës. Ja disa nëngrupe:

a. Frazeologji të motivuara nga jeta e kafshëve (të egra a po të buta): **Si sorkadh mali:** *i kapërcente gjerdhet miku im i shkretë, si sorkadh mali dhe më në fund e kishte mbajtur vrapin në një kanal me ujë.* (f. 95); **E mban vrapin:** *I kapërcente gjerdhet miku im i shkretë, si sorkadh mali dhe më në fund e kishte mbajtur vrapin në një kanal me ujë.* (f. 95); **Sa një pelë hergjele:** *Po jot ëmë qe sa një pelë hergjele, kur rashë në burg unë, more sojsëz e dinsëz me tët ëmë e më gjithë sorollopim tënd!* (f. 111); **Gomar i madh:** *Po, kur dije të shkruaje mirë, siç na thonë, pse nuk shkruaje për Enver Hoshën, o gomar i madh?* (f. 196); **Hajvan me shkollë:** *Kur paske qenë aq i mençur sa thonë, ti të shkruaje për Enver Hoshën o hajvan me shkollë!* (f. 196); **Si të ndjell qenin:** *Duke e futur në korridorin e birucave të katit të parë, njëri nga hetuesit vërshëlleu si të ndillte qenin dhe nga biruca në të majtë të derës u dëgjuan të lehura të shpeshta.* (f. 185); **I provoj brirët me deshtë e kopesë:** *Ore gomar, nuk e merr vesh akoma se ç’ të ka gjetur, po dashke dhe të provosh brirët me deshtë më të mëdhenj të kësaj kopesë tonë?* (f. 207); **Dosë e majme:** *- Ja ajo dosa e majme që ke në krah, na rrahu si kafshë të dyjave!* (f. 259); **Ha nga këmbët dikë:** *- Do t’u bëj patjetër, se të thashë që jemi shokë e nuk hamë njëri-tjetrin nga këmbët, të të hajë dreqi si të hëgri!- nëmi me gjuhën e zonës së tij Kokëpatatja.* (f. 264); **Lë leshtë:** *Për këtë lloj ëndrre të fandaksur po lë leshtë në birucë?* (f. 266); **Si qeni për zinxhiri:** *Kjo na qenka liria që të frymëzon, kur na hidhesh dhe neve për sysh, si ai qeni për zinxhiri?* (f. 266); **Si bagëti e shënuar pas veshit:** *Liri për të qenë i*

barabartë përpara ligjit dhe jo si ca bagëti të shënuara pas veshit nga biografia politike. (f. 266); **Të hyjë derri e dosa:** T’i hapim portat që “**të na hyjnë këtu derri e dosa**” - kur thotë aq bukur udhëheqësi ynë? (f. 267); **I kthen potkonjtë nga dielli:** Në vend që të hedhësh lumin, kështu si vepron ti, ka më tepër mundësi të hedhësh topin e **të kthesh patkonjtë nga dielli!** (f. 251) etj.

b. Frazheologji të motivuara nga bota e bimëve (të egra a po të buta): **Si majë gjembit:** Me ty duhet të rrish si majë gjembit, kur flet. (f. 264); **Sikur e zë në kopshtin e lakrave:** Je afërsisht në moshën e tim biri dhe nuk të skuqet faqja fare, kur më turresh sikur më ke zënë në kopshtin e lakrave! (f. 267) etj.

c. Frazheologji të motivuara nga bota e kulturës: **Rrathët e ferrit:** - **Rrathët e Ferrit** të Dante Aligerit, u them, si t’u thuash ndryshe këtyre shkallëve? (f. 126); **I gjelbër me mendime blu:** - E, more poeti i gjelbër me mendime blu – e theksoi këtë përcaktim si për t’i thënë të burgosurit se ai dinte edhe ato që kishin thënë shokë të afërt për të... (f. 205); **E kishite “zënë kalemi”** - siç thoshte vetë – dhe e kishin transferuar në një kamp stërvitjeje në Gjermaninë Perëndimore. (f. 106); **I tregoi më tepër hollësi për ato furnizimet e bollshme të sovjetikëve, që “punonin në naftë, po nuk i bënë naftën punëtorit, si këta brashnjarët tanë”** - siç thoshte çëçua me atë mënyrën e vet të veçantë. (f. 131) etj.

d. Njësi frazeologjike që lidhen me ngjarje apo figura historike, me rrëfenja, anekdota etj.: **Harro mushkë Valarenë:** Tani nuk talleh dot, siç ke bërë herën e parë...Si i thonë andej nga anët tona: “**Harro mushkë Valarenë / Se Ali pashanë e prenë!**” (f. 195-196); **Kohët e baba Qemos:** Kur zhdëp kështu këtë, që po shkel të gjashtëdhjetat, është mirë t’i vënë gishtin kokës përpara se të hapin gojën ca të mençur në moshë të re, që u duket dhe miniera e kohës së Partisë si minerat e kohës së pirostive a të kusive, se nuk i hyjnë njeriu në punë kohët e baba Qemos. (f. 159); **Hejbetë e shejtanit:** - E di që kjo godina e hetuesisë së përgjithshme më duket si ato “**hejbetë e shejtanit**”, në përrallën që më tregonte gjyshja kur isha fëmijë? (f. 203); **Na u nxi hançia:** Apo na u nxi hançia neve se re në burg ti e shokët e tu e sorollopi juaj! (f. 210); **Si gomarin me ujkun:** E di ti se ku je këtu, apo mos të ka gjetur si atë gomarin, që këtej e kafshonte ujku e këtej i dukej vetja në ëndërr? (f. 225); **Si ai cjapi i përrallës:** – Si ai cjapi i përrallës që tregojnë andej nga vendi im e yti... (f. 225); **Me shëndet sharkun, o Zykë** “**Me shëndet sharkun, o Zykë / Sharku okë e mendja pykë!**” (f. 225) etj.

e. Në përputhje me synimin për të pasqyruar jetën e burgut apo të internimit sa më afër të vërtetës, shumë shpesh, autori ka përdorur shumë njësi të thjeshtligjërimit: **Pa brekë në bythë:** *Na la pa dhallë e pa brekë në bythë, ai qosja i katarisur!* (f. 133); **Mbeti me çitjane në fund të këmbëve:** *Mbeti me çitjane në fund të këmbëve, i iku dhe goja se nuk dinte si t'u thoshte atyre që e thirrën.* (f. 133); **I jep një plumb bythëve:** *Të kemi prurë këtu që të na thuash të gjitha ato që nuk ke thënë herën e parë, të të shkundim mirë e mirë, të të bëjmë pako për në gjykatë e pastaj të të japim dhe një plumb bythëve që të veç në esfelin safili, ku kemi dërguar të gjithë të parët e shokët e tu!* (f. 195); **Si çetur i pagdhendur:** *Ajo bina e madhe me atë kokë si çetur i pagdhendur, që kishte hapur seancën e hetimit në mes të natës, dukej i tëri i fryrë me ahët e birucave.* (f. 195); **Nuk i nxihet bytha:** *- T'ia thoshje që ç'ke me të! Po ia them unë tani e po ia them copë, se nuk na nxihet bytha nga armiku neve!* (f. 195); **Koqe në karroqe:** *Gjersa na thua dhe nevej nazistë, nuk paske koqe në karroqe!...* (f. 195); **O mendje na hëngësh munë:** *Na kësaj mëndjes tënde i themi "o mendje na hëngësh munë!"...* (f. 195); **Ia hedh bythës:** *Ndaj dhe ia hodhe bythës herën e parë e na shpëtove me 20 vjet.* (f. 195); **Ha koqen e plumbit:** *Se do hajë koqen e plumbit, po nuk i thirri mendjes e të merret vesh me ne.* (f. 205); **Sikur fshin çimenton me bythë:** *Apo e ke dashnore këtë dosën e majme, që ecën sikur fshin çimenton me bythë? - i kthehej kapterit e burgosura ordinere.* (f. 259); **Si dhelpira pas koqeve të dashit:** *Ecni, apo më mirë, zvarriteni kot si dhelpira pas koqeve të dashit...* (f. 213)

f. Semantikisht, në libër ndesh jo rrallë njësi frazeologjike me kuptim mohor, që lidhen pazgjidhshëm më natyrën e përmbajtjes së tij: **Nuk më mban më hambari:** *- Fol si të duash e përse të duash me mua, çëço, sa herë që e sheh se nuk të mban më hambari...* (f. 130); **Nuk më prishet gjiza:** *Dhe nuk na prishet gjiza, nëse këtë të vërtetë nuk arrijnë ta besojnë e nuk arrijnë ta shohin ca mbeturina të shoqërisë si puna juaj!* (f. 139); **Nuk e kam thirrur për krushk:** *Këtu nuk të kemi thirrur për krushk, por të kemi marrë të pandehur. E di pse të kemi arrestuar?* (f. 189) etj.

g. Duke parë vlerën leksiko-gramatikore të njësive frazeologjike që kemi vjelë, po veçojmë dy nëngrupe:

- **Frazeologji me vlerë emërore:** **Njeri i leshtë:** *Ai ishte njeri i leshtë, por pa qenë leshko.* (f. 548); **Mall vendi:** *Ishte aq i sjellshëm me të burgosurit, sa nuk e besojë dot që ishte "mall vendi"...* (f. 548); **Çatia e zemrës:** *Gruaja është çatia e zemrës, xhani i vëllait, nëna është çatia e*

kokës. (f. 550); **Çatia e kokës:** Gruaja është çatia e zemrës, xhani i vëllait, nëna është çatia e kokës. (f. 550); **Qen i zgjebosur:** - Po ke folur sa je shkërmoqur, more qen i zgjebosur! – i qe turrur hetuesi dhe e kishte goditur, ashtu siç qe i lidhur me hekura gjermane. (f. 551) etj.

- **Frazeologji me vlerë foljore:** **Zë nën vete:** Kjo, më duket mua, është dhe arsyeja kryesore pse pushteti i mbajtur më këmbë me baltën e shpifjeve e me telat gjëmbaçë të dhunës e me propagandën e ngjyrosur si letër punëdoreje, vjen një ditë që squullet e shpurthiqet e zë nën vete dhe pushtetarët, siç zë me kohë popullin e mbarë vendin. (f. 542-543); **Luan nga vidhat:** - **Luajte nga vidhat,** apo ç’e pate këtë? – u habit Laba. (f. 546); **Hap fjalë:** Komisari dhe operativi me të vetët, hapën fjalë se nënoficeri i furnizimit të burgut ishte **dorëlëshuar** jo vetëm me ushtarët, por dhe me të burgosurit. (f. 546); **I del gjumi:** Flisnin nën zë që **të mos i dilte gjumi** djalit të mitur. (f. 550); **Ka luajtur (nga trutë):** Është bërë gjysmë njeriu, i shkreti, **ka luajtur** në hetuesi. (f. 58); **Nuk e rruaj (bythën):** Nuk trembem, nuk shqetësohem nga dikush a nga diçka. Ja veta, kam plot katër muj e tremdhet ditë sot vetëm këtu në dhomën e bujtsave dhe **nuk e rruj fare!** (f. 59) etj.

Siç shihet nga çfarë trajtuam, “Shënime nga Shkolla e Partisë” i D. Gumenit, zbulohet para lexuesit edhe si një minierë e çmuar dhe pashtershme gjuhësore. Aty mund të gjesh nga të gjitha llojet e mineraleve dhe kushdo e kurdo mund të hyjë e të kërkojë për to. E them me bindje se asnjëherë nuk do të kthehet duarbosh!

Dhe për fund, po i mbyll këto ravijëzime gjuhësore duke risjellë nga libri vargjet e Kudret Kokoshi, “poetit me P të madhe” sipas Daut Gumenit, që përbëjnë dhe lajtmotivin e vetë jetës e luftës së autorit të veprës në të cilën u ndalëm për këto ravijëzime gjuhësore: “*Jetova jetën pak e vuajta shumë / Po dhe në vuajtje prapë dashurova. / Dhe kur të bie të fle të fundit gjumë / Ju mos pandehni, jo, se unë pushova!*” (f. 152)

